UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/63
Datë: 20/4/2018

RREGULLORJA PËR ZGJEDHJET E STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS " HASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: _____

Datë: ___/___/_____

Në bazë të nenit 158, paragrafi 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 19.04.2018, miratoi:

Rregullore

për procedurën e zgjedhjeve të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton procedurën dhe organizimin e zgjedhjeve për anëtarët e Parlamentit të studentëve dhe të Këshillave të studentëve të fakulteteve.

Neni 2

(1) Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët e rregullt, me korrespondencë dhe master.

(2) Secila organizatë studentore duhet të ketë statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj dhe në pajtim me këtë rregullore.

(3) Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.

Neni 3

(1) Interesat e studentëve do të përfaqësohen në Universitet përmes këtyre organeve:
1. Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit;
2. Këshillat e studentëve në nivel të secilës njësisë akademike.

(2) Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve të njësive akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.

(3) Studentët të cilët kanë përsëritur vite të studimeve nuk mund të kandidohen, përkatësisht të zgjidhen në pozita udhëheqëse studentore në UP.

(4) Studentët të cilët janë në vitin e parë të studimeve master e të cilët kandidohen për anëtarë të Senatit duhet të kenë notën mesatare jo më pak se tetë (8) në nivelin e studimeve baçelor.

(5) Studentët që janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike nuk mund të kandidohen në listat zgjedhore të organizatave studentore.

(6) Studenti i cili ka mandat, me rastin e diplomimit menjëherë i ndërpritet mandati i fituar. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës të renditur në listën e certifikuar të kandidatëve.

Parlamenti i Studentëve

Neni 4

(1) Parlamenti i studentëve është organ suprem i përfaqësimit të studentëve. Ai merr vendime për çështjet studentore dhe akademike në nivel të Universitetit.

(2) Parlamenti i studentëve zgjedh anëtarët e Senatit nga lista e të propozuarve, e përgatitur nga këshillat e studentëve të secilës njësi akademike. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar ex-officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit.

(3) Parlamenti i Studentëve zgjedhë shtatë (7) anëtarë të Senatit prej radhëve të studentëve në përputhje me nenin 43 paragrafi 1.5 të Statutit të UP-së.

(4) Parlamenti i studentëve fokusohet në temat si në vijim:
   a) Interesat e studentëve në nivel të Universitetit;
   b) Angazhimi për cilësi në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
   c) Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të Universitetit dhe zhvillimet akademike;
   d) Zhvillimin e cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit;
   e) Bursat universitare;
   f) Ndihmat (bursat) sociale;
   g) Çështjet tjera të përgjithshme të interesave të studentëve dhe
   h) Organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive.

(5) Parlamenti i studentëve merr vendimet si në vijim:
   a) Zgjedhjen e shtatë anëtarëve-studentë në Senatin e UP-së
   b) Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të UP-së
   c) Propozimet për Senatin e UP-së në lidhje me çështjet studentore dhe akademike;
   d) Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e UP-së ku studentët janë anëtarë sipas statutit;
   e) Çështjet tjera që përcaktohen nga parlamenti i studentëve.

Neni 5

(1) Numri i tërësishëm i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve është 17.

(2) Anëtarët propozohen nga organizatat studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore ne fillim të fushatës zgjedhore.

(3) Anëtarët e Parlamentit të studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin.

(4) Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bën fushatë, varet nga numri i përgjithshëm i përqindjes së votave që arrihet gjatë zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.

(5) Votat e organizatave studentore të cilat nuk kanë arritur pragun prej 5% të numrit të përgjithshëm të votave për Parlament të Studentëve, nuk do të shpërndahen në organizatat tjera të kualifikuara për përfaqësim në Parlament të Studentëve.

(6) Zgjedhjet e Parlamentit të Studentëve udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

Këshilli i studentëve

Neni 6

(1) Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.

(2) Secili këshill i studentëve propozon listën me tre (3) kandidatë për anëtarë studentë të Senatit për tu zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.

(3) Këshilli i studentëve i secilës njësi akademike zgjedh anëtarët studentë të këshillit të njësisë akademike. Kryetari i këshillit të studentëve është anëtar ex-officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Këshillit të Fakultetit.

(4) Këshilli i studentëve të fakultetit zgjedhë dy përfaqësues të studentëve për anëtarë të Këshillit të njësisë akademike në përputhje me nenin 73 paragrafi 1.7 të Statutit të UP-së.

(5) Anëtarët e secilit këshill të studentëve zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar.

(6) Secili këshill i studentëve fokusohet në temat si në vijim:
   a) Interesat e studentëve në nivel të njësisë akademike;
   b) Angazhimi për cilësi në mësimdhënie dhe mësimnxënie
   c) Studimet që ndërlidhen me aspekte të reformave të fakultetit dhe zhvillimit akademik;
   d) Zhvillimi i cilësisë të mësimit dhe të vlerësimit;
   e) Bursat universitare;
   f) Ndihmat (bursat) sociale;
   g) Çështjet tjera të përgjithshme në interes të studentëve në nivel të fakultetit

(7) Këshill i studentëve i secilës njësi akademike merr vendime si në vijim:
   a) Përgatitjen e listës së ngushtë për anëtarët-studentë të Senatit;
   b) Zgjedhjet e anëtarëve-studentëve të këshillave të fakultetit;
   c) Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të fakultetit;
   d) Propozimet për këshillin e fakultetit lidhur me çështjet studentore dhe akademike;
   e) Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e fakultetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit;
   f) Çështjet tjera që përcaktohen nga këshilli i studentëve.

Neni 7

(1) Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është 1% i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë njësi akademike, me më së paku 5 dhe më së shumti 21 anëtarë.

(2) Anëtarët do të propozohen nga organizata studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritur gjatë zgjedhjeve të studentëve për secilën njësi akademike sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga organizata studentore në fillim të fushatës zgjedhore.

(3) Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bën fushatë, varet nga totali i përqindjes së votave të arritura gjatë zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.

(4) Votat e organizatave studentore të cilat nuk kanë arritur pragun prej 3% të numrit të përgjithshëm të votave për Këshill të Studentëve, nuk do të shpërndahen në organizatat tjera të kualifikuar për përfaqësim në Këshill të Studentëve.

(5) Zgjedhjet për këshilla të studentëve do të udhëhiqen nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përkatës në bashkëpunim me Komisionin Qendror Zgjedhor.

Parimet e zgjedhjeve

Neni 8

(1) Regjistrimi i organizatave të reja do të bëhet në Ministrinë e Administratës Publike, konform Ligjit në fuqi për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

(2) Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si "shoqatë"–"asociacion" në Ministrinë e Administratës Publike sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara ndërsa themelimi i organizatave të reja duhet të regjistrohet së paku njëzetë (20) ditë para datës së zgjedhjeve.

(3) Organizatat studentore kanë të drejtë të regjistrohen për:
   a. përfaqësim të përgjithshëm të studentëve të universitetit;
   b. përfaqësim të studentëve në fakultete individuale.

(4) Numri minimal i deklaratave mbështetëse nënshkruese i nevojshëm për organizatat studentore për të arritur pranueshmërinë duhet të përcaktohet sipas rregullave të kësaj rregulloreje.

(5) Organizata studentore për t'u regjistruar për herë të parë duhet t'i sigurojë 1500 nënshkrime mbështetëse.

(6) Në deklaratën mbështetëse duhet të shënohet: Emri dhe mbiemri, numri i ID-kartelës së studentit ose Indeksit, nr. personal, fakulteti dhe nënshkrimi origjinal i studentit sipas të bashkangjiturës nr.1.

(7) Në rast se konstatohen parregullsi ose falsifikim me rastin e plotësimit të shënimeve në listat mbështetëse, Komisioni Qendror Zgjedhor, anulon regjistrimin e organizatës.

(8) Listat mbështetëse përveç në lidhje të fortë duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (Excel).

(9) Data kualifikuese për organizatat studentore, për të fituar të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet studentore, do të caktohet pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve. Procesi i regjistrimit dhe licencimit duhet të përfundojë në atë datë.

Neni 9

(1) Anëtarët e parlamentit të studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjedhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.

(2) Përfaqësimi i studentëve në parlamentin studentor do të jetë në bazë të numrit të votave të fituara për Parlamentin e Studentëve.

(3) Gjatë zgjedhjeve do të aplikohet sistemi përfaqësimit proporcional. Kjo siguron që secila organizatë studentore që ka fituar numrin e përgjithshëm të votave mbi pragun përkatës të arritur, do të fitojë numrin e ulëseve në proporcion me përqindjen e votave të cilat i kanë marrë.

(4) Limiti (pragu) për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:
   a) 5% i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e studentëve.
   b) 3% i numrit të përgjithshëm të votave në nivel të njësisë përkatëse akademike për këshillat e fakulteteve të njësive akademike.

Neni 10

Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe i këshillit të studentëve të njësive akademike zgjat 2 vjet.

Neni 11

(1) Zgjedhjet e studentëve shpallen nga Këshilli Drejtues i UP-së.

(2) Zgjedhjet e studentëve mbahen jo më larg se njëzetë e pesë (25) ditë pasi të shpallen zgjedhjet nga Këshilli Drejtues i UP-së. Data e saktë përcaktohet nga Këshilli Drejtues i UP-së.

(3) Organizatat e studentëve që fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjet studentore në nivel universiteti apo fakulteti, duhet të mbajnë fushatën bazuar në listën prioritare të kandidatëve, gjithnjë duke respektuar nenin 7 paragrafi 2 dhe nenin 9 paragrafi 2 të kësaj rregullore.

(4) Periudha e fushatës zgjedhore për organizatat e studentëve do të fillojë në ditën e shpalljes së zgjedhjeve dhe do të përfundojë 24 orë para datës së zgjedhjeve, duke e llogaritur kohën që nga ora 00:00 e ditës së shpalljes së zgjedhjeve. Zgjedhjet do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor, ndërsa do të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë tjera të interesit për monitorim të zgjedhjeve..

(5) Shkeljet e rregullave dhe procedurave zgjedhore do të sanksionohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Këshilli Drejtues si shkallë e dytë.

Komisioni Qendror Zgjedhor dhe Komisionet Zgjedhore të Fakultetit

Neni 12

(1) Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) themelohet nga Këshilli Drejtues në ditën e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, ndërsa brenda dy (2) ditëve të punës pas datës së shpalljes së zgjedhjeve do të konstituohet nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues. Kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor merr përsipër udhëheqjen pas zgjedhjes së tij/saj.

(2) Komisioni Qendror Zgjedhor përbëhet nga anëtarët si në vijim:
1. dy profesor në marrëdhënie të rregullt pune;
2. sekretari i përgjithshëm UP-së;
3. një përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me kompetencat përkatëse ligjore;
4. nga një përfaqësues prej të tri organizatave më të mëdha të studentëve në kuadër të votave të fituar në zgjedhjet e fundit, të cilët nuk mund të jenë kandidatë në asnjë strukturë.
5. një përfaqësues i KQZ të Republikës së Kosovës, në cilësi të monitoruesit pa të drejtë vote.

(3) Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të dërgojë kërkesë me shkrim për të marrë emrat e nominuar nga organizatat dominuese sipas paragrafit (2) të këtij neni ditën e neserme passhpalljes së zgjedhjeve, kjo shkresë duhet të iu dërgohet së bashku me një ftesë për mbledhjen konstituive. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i Këshillit Drejtues më së voni një ditë para mbajtjes së takimit konstituiv. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave.

(4) Komisioni Qendror Zgjedhor zgjedhë kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin me shumicë votash të anëtarëve.

(5) Zëvendëskryesuesi zgjidhet nga mesi i profesorëve anëtarë të KQZ.

(6) Komisioni Qendror Zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore.

(7) Rezultatet e zgjedhjeve shpallen ekskluzivisht nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

(8) Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të aprovojë udhëzimet për votim me propozim të kryesuesit të komisionit brenda shtatë (7) ditëve pas konstituimit.

Neni 13

(1) Për secilin fakultet të UP-së, duhet të themelohet komisioni i zgjedhjeve nga Këshilli i Fakultetit brenda pesë (5) ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve.

(2) Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përbëhet nga anëtarët si në vijim:
1. Një profesor i fakultetit
2. Një asistent i fakultetit

3. nga një përfaqësues prej dy organizatave më të mëdha të studentëve që kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fundit, të cilët nuk mund të jenë kandidatë në asnjë strukturë.
4. Sekretari i fakultetit.

(3) Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor para mbajtjes së takimit konstituiv. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave të konstituimit të KZF-së.

(4) Sekretari i fakultetit është kryesues i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit (KZF). Zëvendëskryesuesi zgjedhet me shumicë votash nga mesi i anëtarëve studentë.

(5) Komisioni Zgjedhor i Fakultetit e përkrah Komisionin Qendror Zgjedhor në përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore në fakultetin përkatës.

Neni 14

(1) Asnjë student nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një zgjedhjeje (mandati) apo komisioni të fakultetit.

(2) Asnjë student nuk ka të drejtë që emri i tij të jetë në më shumë se një listë të kandidatëve.

(3) Asnjë student që është anëtar i një zgjedhjeje (mandati) apo komisioni zgjedhor nuk ka të drejtë të mbështesë listën e kandidatëve apo anasjelltas.

(4) Të gjithë anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe të Komisioneve Zgjedhore të Fakultetit duhet të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim, e cila përgatitet nga kryesuesi i KQZ-së e cila thotë se ata/ato do të punojnë gjatë mandatit të tyre me përpikëri, në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegje të plotë.

(5) Këshilli Drejtues ka të drejtë që përkohësisht të suspendoj anëtarët studentë të zgjedhjeve apo Komisionit Zgjedhor të fakultetit me rekomandim të kryesuesit të komisionit zgjedhor në rast të ndonjë shkelje të dëshmuar të rregullave te kësaj rregulloreje nga anëtarët përkatës. Në këtë rast pozita nuk do të ri-plotësohet për periudhën gjatë suspendimit.

Neni 15

(1) Kryesuesii KQZ-së është përgjegjës për:
- Thirrjen e takimeve të KQZ-së;
- Udhëheqjen e takimeve;
- Udhëzimin për procesin e vendim marrjes;
- Ekzekutimin vendimeve të KQZ-së;
- Koordinimin e komisioneve të fakulteteve.

(2) Kryesuesit të KQZ-së i caktohet një bashkëpunëtor që do ta ndihmojë në kryerjen e punëve teknike dhe përgatijen e procesverbaleve

(3) Këshilli Drejtues është i obliguar që të ofrojë mbështetje të mjaftueshme administrative për kryesuesin e KQZ-së në mënyrë që t`i përmbushë obligimet e përshkruara nga kjo Rregullore.

(4) Nëse kryesuesi mungon, përgjegjësitë sipas paragrafit (1) të këtij neni i ushtron zëvendës kryesuesi.

Neni 16

(1) Secila organizatë e studentëve që kualifikohet për pjesëmarrje në zgjedhjet e studentëve sipas kësaj rregulloreje, dhe e cila nuk është e përfaqësuar në komisionin zgjedhor apo në komisionet e fakultetit, ka të drejtë të nominojë një vëzhgues në komisionin zgjedhor.

(2) Nominimi i vëzhguesëve duhet të bëhet më së largu tri ditë (3) pas kualifikimit të Organizatave të studentëve për pjesëmarrje në zgjedhje.

Neni 17

(1) Në rast të dorëheqjes së hershme të anëtarëve ashtu si janë listuar në nenin 12 paragrafi 2 pika 4 dhe nenin 13 paragrafi 2 pika 3 të kësaj Rregulloreje, Këshilli Drejtues duhet të kërkojë nga organizata deleguese të caktojë nominimin e anëtarit brenda një periudhe prej24 orësh.

(2) Në rast të mungesës së kuorumit të komisionit zgjedhor, për shkak të mos përcaktimit të nominimit, kryesuesi i KQZ-së ka të drejtën të marr vetë vendime.

Neni 18

(1) Në KQZ, duhet të jenë prezent kryesuesi dhe së paku tre anëtarë që të ketë kuorum. KZF duhet ta ketë të pranishëm kryesuesi dhe së paku dy anëtarë më shumë për të arritur kuorumin.

(2) Në rast se mungon kuorumi, kryesuesi mund të thërras një takim tjetër brenda 24 orësh.

(3) Në rast se mungon kuorumi gjatë dy takimeve të njëpasnjëshme,kryesuesi i KZF- së e gëzon të drejtën e marrjes së vendimeve për pikat e rendit të ditës.

(4) Vendimet e KQZ-së dhe KZF-së merren me shumicë votash.

(5) Në rast të votimit të barabartë vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 19

(1) Kryesuesi obligohet që ta ftojë mbledhjen e KQZ-së në afatin e paraparë sipas kësaj rregulloreje, më së voni 24 orë pasi të njoftohen për rastin përkatës.

(2) Thirrja (ftesa) duhet t'i dorëzohet anëtarëve më së voni një ditë para takimit. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës.

Neni 20

(1) Procesverbali i takimit duhet të përgatitet për çdo takim të KQZ-së dhe të KZF-së, sipas të bashkangjiturës nr.2.

(2) Procesverbali duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të takimit dhe të vendimeve që janë marrë. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga kryesuesi i KQZ-së, përkatësisht KZF-së.

(3) Të gjitha procesverbalet e takimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Komisionit Zgjedhor i Fakultetit duhet të ruhen nga kryesuesi përkatës. Nga një kopje për secilin takim duhet t'i dorëzohet sekretarit të përgjithshëm të UP-së të cilat duhet të ruhet në arkivin e UP-së për një periudhë prej tri vjetësh.

Neni 21

(1) Takimi i KZF-së duhet të thirret nga kryesuesi i KZF-së.

Neni 22

(1) Komisioni Qendror Zgjedhor ka këto përgjegjësi:
1. zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve të përcaktuar nga Këshilli Drejtues;
2. përgatitjen e listave për zgjedhje të studentëve me të drejtë zgjedhjeje;
3. vendimet rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
4. konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
5. vlerësimi i listës së kandidatëve;
6. kryesimi i procedurave zgjedhore;
7. verifikimi përfundimtar i identitetit të votuesve;
8. konstatimi i rezultateve të zgjedhjeve;
9. dhënia e mandatit për t'i pranuar organizatat dhe kandidatët e zgjedhur;
10. informimi i kandidatëve;
11. shpallja e rezultateve të zgjedhjeve;
12. zëvendësimi i mandatit;
13. konstituimi i parlamentit të studentëve;
14. koordinimi i komisioneve zgjedhore të fakulteteve për konstituimin e këshillave të studentëve.

(2) Lista e organizatave të certifikuara të studentëve duhet të shpallet në ueb-faqe të UP-së www.uni-pr.edu më së voni 14 ditë para ditës së zgjedhjeve.

(3) Listat përfundimtare të kandidatëve duhet të shpallen publikisht më së voni shtatë(7) ditë para ditës së zgjedhjeve.

(4) Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve shpallen publikisht brenda 5 ditëve pas datës së zgjedhjeve.

(5) Mandatet caktohen jo më vonë se shtatë (7) ditë pas ditës së zgjedhjeve.

Neni 23

(1) Administrata Qendrore dhe shërbimi i studentëve të njësive akademike janë të obliguar t'ia sigurojnë listën e përfunduar KQZ-së, me të gjitha të dhënat e

studentëve që kanë të drejtë vote, më së voni shtatë (7) ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të studentëve nga Këshilli Drejtues.

(2) Studentët me të drejtë vote duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
   a) Të kenë statusin e studentit të rregullt / korrespondencë sipas Nenit 146, paragrafi 1, i Statutit të UP-ës.
   b) Studentët me Indeks të vulosur ose ID me të cilin dëshmohet që studenti e ka regjistruar vitin akademik në të cilin mbahen zgjedhjet.

(3) Listat e studenteve që kanë të drejtë vote duhet të bëhet publike dhe të jetë e qasshme për KQZ-në dhe studentët brenda shtatë (7) ditëve passhpalljes së zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues.

(4) Listat finale të studentëve me të drejtë vote do të publikohen jo më vonë se dhjetë (10) ditë para datës së zgjedhjeve.

(5) Brenda kësaj periudhe secili student ka të drejtë të ankohet kundër përmbajtjes së listës përmes deklaratës me shkrim e cila mund t'i paraqitet kryesuesit të KQZ-së.

(6) Ankesat kundër listës së studentëve me të drejtë vote mund të paraqiten më së voni 1 ditë para para datës së zgjedhjeve . Lidhur me ankesat vendoset brenda 24 orëve pas pranimit të ankesës.

Lista e kandidatëve

Neni 24

(1) Organizatat e studentëve me të drejtë pjesëmarrje në zgjedhje për parlament studentor apo këshilla të studentëve sipas kësaj rregulloreje duhet të dorëzojnë listat e kandidatëve në formatin Excel, drejtëpërdrejtë në KQZ, ose përmes postës elektronike më së voni dhjetë (10) ditë para zgjedhjeve, duke aplikuar formularin e Listës së Kandidatëve ashtu siç është paraqitur nga KQZ në sipas të bashkangjiturës nr. 3. Pasi të dorëzohen listat në KQZ, ato nuk do të ndryshohen apo plotësohen me kandidatë të ri.

(2) Secila listë e kandidatëve duhet të përmbajë:
   a) Emrin e organizatës së studentëve;
   b) Organin qeverisës që do të zgjedhet(parlamentin studentor apo këshillin e studentëve);
   c) Listën e kandidatëve sipas renditjes;
   d) Deklaratën e pëlqimit të kandidatëve;
   e) Personi i autorizuar i organizatës studentore;

(3) Në rast të emërtimeve të njëjta të dy apo më shumë organizatave studentore, KQZ duhet të kërkojë nga personat e autorizuar të secilës organizatë që së paku 10 ditë para ditës së zgjedhjeve të arrijnë marrëveshje se kush do ta bartë atë emërtim. Në rast se nuk gjendet ndonjë marrëveshje deri në atë datë, KQZ vendosë për përjashtim nga zgjedhjet të organizatës e cila është regjistruar e fundit.

(4) Organizatat studentore, të cilat kanë qenë të certifikuara edhe më parë në përfaqësimin e studentëve të UP-së, do të kenë të drejtën t'i mbajnë emrat e tyre.

(5) Përdorimi i emrave të partive politike ekzistuese të Kosovës, si emra të organizatave të studentëve nuk lejohet.

Neni 25

(1) Lista e kandidatëve e organizatave studentore duhet të përbëhet prej minimumit, sa dyfishi i mandateve të lejueshme për KS/PS.

(2) Asnjë studentë që nuk figuron në listën e kandidatëve të publikuar nga KQZ, nuk mund të ushtroj mandat në Këshill të Studentëve apo Parlament të Studentëve.

(3) Për secilin kandidat, që përmbushë kriteret e përcaktuara sipas nenit 23, pragrafit (2), në mënyrë që kandidatura të jetë e ligjshme duhet të ofrohen të dhënat si në vijim:
   a) Emri (at) dhe Mbiemri
   b) Vendi i lindjes
   c) Data e lindjes
   d) Adresa
   e) Fakulteti
   f) Numri i indeksit të studentit apo ID kartelës
   g) Dëshmia e regjistrimit të studentit të rregullt–vula
   h) Deklarata e pëlqimit.

(4) Kandidatët të cilët nuk i përmbushin kriteret për të pasur të drejtë vote sipas nenit 23 paragrafi (2), KQZ i largon nga lista e kandidatëve.

Neni 26

(1) Në listën e kandidatëve, çdo i treti kandidat duhet të jetë femër.

(2) Për detaje tjera të përfaqësimit gjinor të listës së kandidatëve, KQZ mund t'i referohet Ligjit në fuqi për Barazi Gjinore.

Neni 27

(1) Vlefshmëria e listës së kandidatëve duhet të kontrollohet nga KQZ menjëherë pasi të merret nga organizatat studentore.

(2) Në rast të parregullsive, lista e kandidatëve duhet të kthehet mbrapa te përfaqësuesi i autorizuar i organizatës studentore përkatëse, me shpjegimet e nevojshme për përmirësim.

(3) Lista e përmirësuar e kandidatëve duhet të dorëzohet nga organizata studentore në KQZ, më së voni shtatë (7) ditë para zgjedhjeve.

(4) Nëse lista zgjedhore apo lista e kandidatëve, e cila është kthyer për përmirësim, nuk dorëzohet brenda periudhës kohore të caktuar, kandidatura e organizatës përkatëse studentore konsiderohet e tërhequr.

Neni 28

(1) Secila organizatë studentore do të ketë të drejtën të tërheqë kandidaturën e saj përmes deklaratës me shkrim, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga përfaqësuesi autorizuar i organizatës studentore, me së voni shtatë (7) ditë para zgjedhjeve.

(2) Kandidatura e organizatës studentore do të konsiderohet e tërhequr, nëse numri i kërkuar i kandidatëve sipas kësaj rregulloreje nuk është dhënë për arsye se kandidatët kanë tërhequr kandidaturën me shkrim dhe deklaratën e nënshkruar, më së voni 7 ditë para zgjedhjeve.

Neni 29

(1) Lista zgjedhore apo lista e kandidatëve e cila nuk dorëzohet brenda periudhës së caktuar nuk pranohet nga KQZ.

(2) Për vlerësimin e datës së saktë të dorëzimit të listave, vendimtare do të jetë data e dorëzimit personal nga personi i autorizuar. .

(3) KQZ është e obliguar të organizojë në periudhën para zgjedhjeve një fushatë informuese përmes fletushkave për studentët me të drejtë vote, duke i informuar për procedurat zgjedhore. Këshilli Drejtues është i obliguar të ofrojë resurset e nevojshme për një proces të tillë zgjedhor dhe të njëjtat t'i bëjë publike.

Mbajtja e zgjedhjeve

Neni 30

(1) Qendrat e vendvotimeve në të gjitha njësitë akademike hapen në ora 08.00 dhe mbyllen në ora 17.00, përjashtimisht nga kjo nëse në kohën e mbylljes së vendvotimeve ka radhë të votuesve atëherë koha e mbylljes së vendvotimit shtyhet deri në votimin e studentit të fundit.

(2) Numrin e vendvotimeve nëpër fakultete e cakton KQZ.

Neni 31

(1) KZF obligohet të sigurojë vendvotime të përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve në secilën ndërtesë të fakultetit. Pajisjet e nevojshme, siç janë kutitë e votimit, kabinat e votimit dhe pajisje tjera logjistike të domosdoshme për vendvotim duhet të sigurohen nga KQZ.

(2) Gjatë procesit të zgjedhjeve, në vendvotime mund të kenë qasje përveç anëtarëve të KQZ-së dhe KZF-së edhe personat si në vijim:

- vëzhguesit zyrtar të caktuar për zgjedhje;
- votuesit;
- personeli tjetër i caktuar zyrtar, përgjegjës për funksionim të rregullt të zgjedhjeve.

(3) Pas votimit, votuesi duhet të largohet nga vendvotimi pa vonesë.

(4) Nëse paraqitet e nevojshme për arsye të funksionimit të rregullt të procedurës zgjedhore, kryesuesi i KQZ-së ose KZF-së ka të drejtë të kufizoj qasjen e votuesve në vetëm nga një votues sipas radhës.

(5) Në hyrje të vendvotimeve nuk lejohet prezenca e personave të paautorizar (shih paragrafin 2 të këtij neni).

(6) Për pengesa eventuale të procesit zgjedhor nga personat e paautorizuar do të ndërmirren masa disiplinore adekuate (përjashtim nga kandidatura, suspendim nga fakulteti në kohëzgjatje prej 3, 6 ose 12 muaj).

Neni 32

(1) Secili vend votim duhet të ketë së paku një kabinë votimi.

(2) Kabina e votimit duhet të vendoset në atë pozicion që votuesi të mos jetë i vëzhguar nga persona të tjerë që janë të pranishëm në vendvotim gjatë procedurës së votimit.

Neni 33

(1) Fletëvotimet për Këshilla të studentëve dhe Parlament të studentëve duhet të dallohen përmes ngjyrës.

(2) Fletëvotimet duhet të palosën së paku njëherë para se të hedhën në kutinë e votimit.

Neni 34

KQZ, respektivisht KZF dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë në zgjedhje janë përgjegjës për respektimin e procedurave zgjedhore në pajtim me rregulloren për zgjedhje.

Neni 35

Votimi duhet të bëhet personalisht. Personat me nevoja të veçanta të cilët nuk mund të votojnë pa ndihmën e personit përcjellës, kanë të drejtë të zgjedhin një person i cili do ti ndihmojë në votim.

Neni 36

(1) Secili votues është i obliguar ta dëshmojë identitetin e tij / sajë para KZF-së përmes paraqitjes së ID-kartelës së studentit ose indeksit.

(2) Vlerësimi i pranueshmërisë duhet të bëhet në bazë të listës zgjedhore për personat që kanë të drejtë votimi.

Neni 37

(1) Secili student me të drejtë vote ka të drejtë të votoj për:
   a. parlamentin studentor të universitetit;
   b. këshillin e studentëve në fakultetin ku ai/ajo është listuar si student me të drejtë vote.

(2) Në rast se ndodh ndonjë gabim nga votuesi gjatë plotësimit të fletëvotimit, me kërkesën e votuesit KZF obligohet t'i ofrojë edhe një fletëvotim. Fletëvotimi paraprak duhet të anulohet nga KZF në prani të votuesit.

(3) Dorëzimi i fletëvotimit shtesë duhet të regjistrohet në protokollet e votimit.

Neni 38

(1) Studenti i cili ka votuar, duhet të regjistrohet në regjistrin e votimit nga një anëtar i KZF-së. Për regjistrim përdoret Formulari i bashkangjitur nr. 4 i kësaj rregulloreje.

(2) Emri duhet të regjistrohet me numrin rendor origjinal të listës së votuesve me të drejtë vote.

(3) Anëtari tjetër i KZF-së duhet të evidentoj emrin e votuesit në listën e votuesve me të drejtë vote.

Neni 39

Votimi duhet të regjistrohet me vulë në anën e prapme të brendshme të indeksit nga një anëtarë i KZF-së, ndërsa për studentët me ID-kartelë, regjistrimi bëhet përmes markerit special në pjesën e prapme të kartelës.

Neni 40

(1) Në rast të dyshimit të identitetit të studentit, KZF, ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë.

(2) Nëse identiteti i studentit nuk mund të qartësohet, ai ose ajo nuk lejohet të votojë.

(3) Pasi të dorëzohet fletëvotimi, asnjë dyshim tjetër sa i përket identitetit të votuesit nuk merret parasysh.

Neni 41

(1) Për fletëvotim përdoret formulari i Fletëvotimit sipas të bashkangjiturës nr.5 të kësaj rregulloreje.

(2) Renditja e organizatave studentore në fletëvotim përcaktohet me hedhje të shortit e cila realizohet nga KQZ menjëherë pas certifikimit të organizatave studentore.

(3) Përgatitja e fletëvotimeve duhet të realizohet nga KQZ dhe personeli teknik i KQZ-së sipas dinamikës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 42

Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm, nëse aty ka evidencë të pa diskutueshme për organizatën studentore të cilin votuesi e ka zgjedhur. Ky është rasti kur votuesi shënon në të majtë të emrit të organizatës së pranueshme me iks (x) apo me tik (✓), në mënyrë që qëllimi i votuesit për të zgjedhur organizatën përkatëse të tregohet me qartësi.

Neni 43

(1) Fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm, nëse:
   a) Fletëvotimit i shqyhet një pjesë në atë mënyrë që nuk do të ketë mundësi të qartësohet se cila organizatë studentore është zgjedhur;
   b) asnjë organizatë studentore nuk është shënuar;
   c) dy apo më shumë organizata studentore janë shënuar;

d) shenjat në fletëvotime janë bërë në atë mënyrë që nuk mund të përcaktohet se cila organizatë studentore është votuar.

(2) Fjalët, komentet apo shenjat tjera të cilat shënohen në fletëvotim e bëjnë fletëvotimin të pavlefshëm.

Neni 44

(1) Pasi të përfundojë periudha zgjedhore, kryesuesi i KZF-së, konstaton përfundimin e votimeve. Vendvotimi duhet të mbyllet nga anëtarët e KZF-së në praninë e vëzhguesve dhe monitoruesve të interesuar.

(2) Pas mbylljes së vendvotimit dhe kutive të votimit, KZF fillon numërimin e votave.

(3) KZF, i zbrazë kutitë me fletëvotime dhe:
   a) numëron fletëvotimet për secilin organ të votuar;
   b) konstaton numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listat e votimeve;
   c) konstaton mospërputhjen eventuale të numrave sipas pikës 1dhe 2 të këtij paragrafi.

(4) KZF, shpalos fletëvotimet, i rregullon sipas organit të votuar, kontrollon vlefshmërinë, identifikon fletëvotimet e pavlefshme sipas numrit të radhës dhe e konstaton:
   a) Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura në kuti të votimit;
   b) Numrin e përgjithshëm të votave të pavlefshme;
   c) Numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme për secilën organizatë studentore.

(5) Rezultatet sipas pikës (4) të këtij neni, menjëherë pas numërimit të votave i dorëzohen kryesuesit të KQZ-së në kopje të fortë dhe elektronike.

Neni 45

(1) Brenda 24 orëve pas mbylljes së vendvotimit KZF duhet të dorëzojë në KQZ raport me shkrim për rezultatet preleminare të zgjedhjeve. Për raportim duhet të plotësohet formulari i Protokollit të Procedurës së Zgjedhjeve sipas të bashkangjiturës nr.6 të kësaj rregulloreje.

(2) Raporti duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:
   a) Emrin e vendvotimit dhe datën e votimit;
   b) Emrat e anëtarëve të KZF-së;
   c) Emrat e vëzhguesve dhe monitoruesve;
   d) Numrin e saktë të fletëvotimeve të dorëzuara për secilin organ të votuar;
   e) Koha e fillimit dhe e mbarimit të votimit;
   f) Vendimet e KZF-së për moslejimin eventual të ndonjë votuesi për votim;
   g) Vendime tjera të KZF-së gjatë periudhës së zgjedhjeve (p.sh. pengimet gjatë periudhës së zgjedhjeve, votimet përmes përcjelljes mbështetëse të ndonjë personi etj).

(3) Raportit të KZF-së përkitazi me zgjedhjet i bashkëngjiten:
   a) Lista e votuesve me të drejt vote;

b) Regjistri i votimit;
c) Votat e pavlefshme, të ndara, paketuara dhe të shënuara për secilin organ që është në zgjedhje;
d) Votat e vlefshme, të ndara, paketuara dhe të shënuara për secilin organ që është në zgjedhje;
e) Fletëvotimet e pa shfrytëzuara.

(4) Raporti duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të KZF-së, vëzhguesve dhe monitoruesve. Në rast të refuzimit të nënshkrimit, arsyet duhet të evidentohen në raport.

Neni 46

(1) Në rast të rrethanave të veçanta apo incidenteve në vendvotim, KZF mund të ndërpres procesin e votimit dhe të vazhdojë votimin në një ditë tjetër.

(2) Secila shtyrje e zgjedhjeve duhet të shpallet në publik pa vonesë nga kryesuesi i KZF-së.

(3) Nëse procesi i votimit ka filluar dhe pastaj pengohet, të gjitha fletëvotimet dhe kutitë e votimit duhet të mbyllen nga kryesuesi i KZF-së derisa procedura zgjedhore të vazhdohet.

Neni 47

(1) Shpërndarja e mandateve bëhet nga KQZ në pajtim me këtë rregullore.

(2) Për shpërndarjen e mandateve, duhet të përdoret formulari sipas të bashkangjiturës nr.7 të kësaj rregullore.

Neni 48

(1) Rezultati preliminar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ, më së largu 24 orë pas përfundimit të zgjedhjeve.

(2) Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ, më së largu 5 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.

(3) Shpallja duhet të përmbajë:
a) Rezultatin e zgjedhjeve në numra të renditur sipas organizatës studentore;
b) Numrin e përgjithshëm të mandateve për secilën organizatë studentore të votuar;
c) Listën e kandidatëve për secilin organ.

Neni 49

(1) Mandatorët e zgjedhur duhet të informohen nga KQZ dy (2) ditë pas shpalljes së zgjedhjeve përfundimtare.

(2) Për letrën informuese mund të përdoret formulari për Njoftimin e Mandatarëve sipas të bashkangjiturës nr.8 të kësaj rregulloreje.

(3) Mandati konsiderohet i pranuar, nëse mandatari nuk e kundërshton zgjedhjen e tij brenda dy (2) ditëve pasi që rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të jetë shpallur.

(4) Në rast të kundërshtimit nga mandatari, mandati duhet t'i caktohet kandidatit vijues sipas renditjes së listës së kandidatëve.

Neni 50

(1) Ankesat kundër procedurave të zgjedhjeve në ditën e votimit, duhet t'i dorëzohen KQZ-së më së largu 24 orë pas përfundimit të orarit zyrtar të zgjedhjeve (17.00^{h}).

(2) Ankesat kundër rezultateve të zgjedhjeve të studentëve duhet t'i dorëzohen KQZ-së brenda 48 orëve pasi të jenë shpallur rezultatet preleminare të zgjedhjeve.

(3) Ankesat eventuale të studentëve dhe organizatave studentore ndaj rezultateve zgjedhore, shqyrtohen dhe vendosen nga KQZ brenda 48 orëve pas pranimit të tyre.

(4) Ankesat për arsye të shkeljeve të rregullave të kësaj rregulloreje nga KQZ, duhet të shqyrtohen dhe vendosen nga Këshilli Drejtues i UP-së si shkallë e dytë.

(5) Çdo ndryshim në rezultatin e zgjedhjeve për arsye të pranimit të ankesave duhet të shpallet publikisht nga KQZ.

(6) Vendimi i Këshillit Drejtues lidhur me ankesat e shqyrtuara është përfundimtar.

Neni 51

Nëse Këshilli Drejtues konstaton se shkeljet e procedurave të zgjedhjeve kanë qenë të atyre përmasave të cilat esencialisht kanë ndikuar në rezultatin zgjedhor, procesi zgjedhor do të përsëritet sipas procedurës së njëjtë vetëm në fakultetin përkatës, brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së vendimit nga Këshilli Drejtues.

Neni 52

(1) Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja nr. 4/544 e datës 24.12.2015.

(2) Për çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit të UP-së.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" UNIVERSITY OF PRISHTINA 1970

Mr. Ardiana Bunjaku

Kryesuese e Këshillit Drejtues